



NGROHTORJA E QYTETIT SH.A. GJAKOVË DISTRICT HEATING J.S.C. GJAKOVA

Adresa: "Tirana", pn GJAKOVË, KOSOVË
Tel & Fax: +381 (0) 390 328-329

Nr. i Biznesit: 70325312
www.ngrohtorja.org

Më 20.09.2018

Nr. 336

<i>Për:</i>	Z. Arsim Janova, u.d. Kryetar i Bordit te ZRRE-së
<i>Cc:</i>	Z. Astrit Saraqini, Udhëheqës i Departamentit për Energji Termike dhe Gas-ZRRE
<i>Nga:</i>	Admir Shala, Kryeshef Ekzekutiv i N.P. Ngrohtorja e Qytetit SH.A. Gjakove
<i>Lënda:</i>	Njoftim për mos-aplikim për tarifa të reja për sezonin 2018/2019

Të nderuar,

Në lidhje me shqyrtimin e tarifave për sezonin 2018/2019, dëshirojmë të ju njoftojmë me gjendjen aktuale në NQ Gjakova dhe me disa fakte, që sipas mendimit tonë e pamundësojnë një aplikim tarifor të kompletuar dhe të bazuar në parashikime reale, për një shqyrtim të mirëfilltë tarifor.

Meqenëse edhe në këtë sezon prodhimi i energjisë termike do të jetë i bazuar në lëndën djegëse – mazut, që për ne paraqet një kosto të papërbalueshme financiare, operimi i NQ Gjakovë, do të jetë i varur nga subvencionet prej buxhetit të Kosovës edhe për vitin 2018 për çfarë tanimë janë siguruar mjetet financiare dhe kjo shpresojmë do të vazhdojë edhe në vitin 2019 ashtu që të mund të sigurojmë një furnizimi të qëndrueshëm gjatë sezonit 2018/2019 sikurse edhe viteve paraprake.

Siç jeni në dijeni, NQ Gjakovë është përfituese e projektit në vlerë prej rreth 12 milion Euro të financuar nga BE-ja për ndërrimin e lëndës djegëse dhe jemi në fazën e përzgjedhjes së kontraktorit me çfarë pritet të ofrohet ngrohje e pandërprerë në të ardhmen për konsumatorët tanë andaj deri atëherë shpresojmë ti furnizojmë në kuadër të mundësive që na lejojnë. Posaçërisht ngritja e numrit të konsumatorëve që furnizohen nga NQ Gjakova viteve të fundit na obligon që, përkundër vështirësive financiare të vazhdojmë me operim dhe furnizim të konsumatorëve, ashtu që të mbajmë një kontinuitet deri në implementimin e projektit për impiantin e ri të kogjenerimit.

Nga sa u theksua me larte, konsiderojmë se në këto rrethana është vështirë të bëjmë një aplikim tarifor të kompletuar dhe të bazuar në parashikime reale.

Shpresojmë se do mirëkuptoni situatën tonë momentale dhe faktet e përshkruara më lartë

*Me respekt,
Admir Shala
Kryeshef Ekzekutiv
N.P. Ngrohtorja e Qytetit SH.A. Gjakovë*